

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA
E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Nr. 999/Prot.
1

Tiranë, me 7. 06. 2002

L ë n d a: Për ngjarjet aksidentale në rrjetin hekurudhorë.

**PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË**

Kohët e fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Hekumdhave Durrës ka ringritur shqetësimin, në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe në Mnistrinë e Rendit Publik, për vonesa në lëvizjen e trenave të udhëtarëve, të ndaluar nga policia gjyqësore dhe policia e rendit, për *dy* ngjarje aksidentale në hekurudhë, siç janë:

- me datë 14. 05. 2002, ngjarja e ndodhur në stacionin hekurudhor në Fier, me trenin e udhëtarëve Nr. 18, që lëvizte nga Vlora për në Tiranë, me pasojë një vdekje, duke u shkaktuar vonesë në orarin e lëvizjes së trenave për rreth 1 orë, dhe;
- me datë 9. 05. 2002, në stacionin hekurudhor Durrës, treni i udhëtarëve Nr. 23, që lëvizte nga Tirana për në Vlorë, është kontrolluar dhe verifikuar, me pretendimin se në zonën e Lushnjes, në mëngjezin e asaj dite, ishte konstatuar një qytetar i aksidentuar në vijën hekurudhore, duke u shkaktuar vonesa në orarin e lëvizjes së trenave për rreth 30 minuta.

Vonesat në orarin e lëvizjes së trenave kanë shkaktuar çrregullime në trafikun hekurudhor, i cili funksionon në sistem, në kordinim dhe në unitet, në të gjithë rrjetin hekurudhor.

Duke vlerësuar, shqetësimin e ngritur, për vonesat në orarin e lëvizjes së trenave, në rastet e ngjarjeve aksidentale hekurudhore;

Kisur nga detyrimi ligjor,

- që ndalon qëndrimin dhe lëvizjen e njerëzve ose të kafshëve dhe kullotjen e gjësë së gjallë në vijat hekurudhore, neni 18 paragrafi 3 i Kodit Hekurudhor në fuqi, i miratuar me ligjin Nr. 7224 datë 22. 06. 19988, dhe;
- që detyron, Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave, në raste aksidentesh, avarie..., për të marrë masa në dhënien e ndihmës të dëmtuarve, për ruajtjen e gjurmëve që vertetojnë shkakun e avarisë ose të aksidentit dhe për të rivendosë lëvizjen normale të trenave, neni 39 i këtij kodi.

Me synim,

- eliminimin e vonesave të pamotivuara, në orarin e lëvizjes së trenave dhe;
- shmangien/reduktimin e vonesave, në maksimumin e mundëshëm, për kyerjen e veprimeve të para të domosdoshme hetimore, në rastet e ngjarjeve aksidentale në rrjetin hekurudhor.

1. Tërheq vemendjen për dy rastet e lartpërmendura dhe **ngarkoj drejtuesit e Prokurarive** pranë Gjykatave të shkallës së parë, ***për të marrë masat e duhura organizative dhe për të kontrolluar, kryerjen mbrenda afateve optimale, të veprimeve procedurale, rre raste ngjarje aksidentale hekiuvdhore, pa krtjucir vonesa në trafikun e trenave.***
2. Në këto raste, duhet të **bashkëpunohet me përfaqësuesit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave, e cila ka detyrimet ligjore të lartpërmendura, si dhe ka shprehur gatishmërinë, për të krifucLr kushte të përshtatshme, organeve të proeedimit penal, në kryerjen e procedurave ligjore.**

Me këtë qarkore të njihen, të gjithë prokurorët pranë Gjykatave të shkallës së parë dhe oficerët/agjentët e policisë gjyqësore të Seksioneve dhe të Shërbimeve, në rrethet ku funksionon rrjeti hekurudhor.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU



